



Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



Tiranë, më 27.09.2017

NJOFTIM PËR SHTYP

Tetori Gjerman 2017: Program i larmishëm me pika kulmore të shumta

Një vjeshtë interesante, e larmishme dhe emocionuese është duke ju pritur - Tetori Gjerman 2017. Këtë vit javët tona të kulturës gjermane në Shqipëri do të zhvillohen nën moton "30 vjet prej lidhjes së marrëdhënieve diplomatike mes Gjermanisë dhe Shqipërisë". Është hera e 11-të radhazi, që Ambasada Gjermane në Tiranë, në bashkëpunim me partnerë të shumtë, organizon javët e kulturës gjermane në Shqipëri.

Traditë me vendin e saj në jetën kulturore gjermano-shqiptare

„Tetori Gjerman“ po zhvillohet për herë të njëmbëdhjetë. „Dhe është shndërruar kësisoj në një traditë të vërtetë, që ka vendin e vet në jetën kulturore gjermano-shqiptare“, u shpreh Ambasadorja gjermane Susanne Schütz gjatë prezantimit të programit në dt. 27.09.2017 në Ambasadën Gjermane. „Edhe këtë vit dëshirojmë të arrijmë që shqiptarët dhe gjermanët bashkarisht të jenë kreativë, të përjetojnë së bashku e të shkëmbehen rreth këtyre përjetimeve, të punojnë për një produkt, të ngrenë ura ndërlidhjeje e në rastin më të mirë të mësojnë prej njëri-tjetrit. Ndaj shkëmbimi i mendimeve dhe përvojave mes gjermanëve dhe shqiptarëve do të jetë edhe këtë herë ideja qendrore dhe elementi lidhës i Tetorit Gjerman.“

Përgjatë pothuaj shtatë javëve në vijim në Tiranë dhe qyte të tjera të Shqipërisë do të zhvillohen aktivitete të ndryshme në kuadër të Tetorit Gjerman. Ambasada Gjermane ka krijuar edhe këtë herë së bashku me partnerë dhe mbështetës të shumtë një program mjaft të larmishëm. Filma dhe letërsi, arte figurative, teatër, muzikë dhe vallëzim sikurse diskutime dhe workshop-e - programi ynë ofron diçka për çdo shije.

Më shumë rreth disa aktiviteteve

Për çeljen festive të Tetorit Gjerman Ambasada Gjermane organizon në datën 30.09. në Katedralen Ortodokse së bashku me Teatrin e Operas dhe Baletit Tiranë koncertin „Rekuiem Gjerman“ - veprën e parë të madhe për kor dhe orkestër nga Johannes Brahms.





Ambasada
e Republikës Federale të Gjermanisë
Tiranë



Orkestra e operas dhe kori do të drejtohen prej dirigjentit gjerman Ekhart Wycik, profesor në shkollën e lartë të muzikës në Weimar. Krahas sopranos shqiptare pjesa e dytë solo merret përsipër nga baritoni gjerman Henryk Böhm.

Edhe në teatër do të kemi një premierë: Ambasada gjermane së bashku me regjisorin shqiptar Stefan Capaliku sjellin për herë të parë në skenë në gjuhën shqipe pjesën "Jashtë derës" të autorit Wolfgang Borchert. Në këtë punë të tij Capaliku do të tregojë, se cilat prej mesazheve të Borchert vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot.

Një tjetër *highlight* i pret vizitorët edhe në lëmin e arteve figurative. Me ekspozitën e Institutit për Marrëdhëniet me Jashtë (ifa) „Rosemarie Trockel“, e cila do të shfaqet prej dt. 24.10. deri më 03.12. Ambasada Gjermane dhe Galeria Kombëtare do t'i ofrojnë publikut shqiptar një udhëtim eksplorues përmes veprës së kësaj artisteje shumëdimensionale e të famshme në nivel ndërkombëtar: duke nisur nga vizatimet, fotografitë, tablotë e famshme me thurje e deri tek „makineria e pikturës“ dhe videoinstalacionet.

Letërsia do të sjellë në Shqipëri me ftesë të Ambasadës Gjermane dhe Qendrës Gëte dy autorë gjermanë, poeten Daniela Danz dhe autorin e vlerësuar me çmim të librave për fëmijë Jürgen Banscheraus.

Këngë të vjetra popullore shqiptare do të prezantohen nën një petk të ri nga këngëtarja me banim në Berlin Fatime Kosumi dhe grupi i saj ANDRRA. Meloditë tradicionale do të sillen të mbështjella në një veshje melankoliko-elektronike.

Pjesë e programit janë edhe klasikët e sprovuar tanimë. Për katër ditë në kinemanë Millenium do të shfaqen filma gjermanë të suksesshëm me titra në gjuhën shqipe: „Tapë dhe xurxull“, „Sy për sy“, „Lamtumirë Evropë!“ dhe „Katër mbretërit“. Filma të tjerë janë pjesë e programit për qytetet Shkodër dhe Elbasan.

Programin e plotë të aktiviteteve e gjeni në adresën www.tetori-gjerman.com, dhe faqen e Ambasadës Gjermane www.tirana.diplo.de sikurse edhe në Facebook „[Ambasada Gjermane Tiranë](https://www.facebook.com/AmbasadaGjermaneTirane)“.

Si për çdo vit edhe këtë herë programi i tetorit Gjerman është krijuar në bashkëpunim me partnerë të shumtë gjermanë e shqiptarë dhe mundësuar me mbështetjen bujare të një numri të madh sponsorizuesish.

Johannes Dietrich

Drejtues i Referatit të Kulturës dhe Shtypit

